



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GRAMSH

DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, BUJQËSISË, MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 3518 / Prot.

Gramsh, më 22.09.2022

Lënda : **Dërgim Informacioni.**

Drejtuar : **Znj. Fatbardha NERGJONI** ✓

Adresa : Hotel Turizmi "Skampa", e-mail, nergjonibardha@gmail.com

ELBASAN

Në përgjigje të kërkesës Tuaj nr.335, datë 07.09.2022 "Kërkesë për informacion", e protokolluar në Bashkinë Gramsh me NR.REGJ.3518, datë 08.06.2021, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet pranë Bashkisë Gramsh, bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", të ligjit nr.5/2016, datë 04.02.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive" i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera drusore e jodrusore", si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.02, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime, me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", ju informojmë si më poshtë ;

Numri i kontratave për shfrytëzimin e pyjeve që ka lidhur Bashkia Gramsh me subjektet juridike dhe fizike të cilat kanë dalë fituese në ankandet e zhvilluara për dy vitet e fundit (2020-2021) deri në shtator 2022 është 3(tre), ku 1(një) kontratë është për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë të materialit drusor të dalë përgjatë traseve të linjave elektrike të TM(nënstacioni Gramsh), 1(një) kontratë është për shfrytëzimin e lëndës drusore të përfituar nga materiali drusor të vlerësuar në ngastrat pyjore të dëmtuara nga faktorët të ndryshëm natyrore dhe nga zjarret dhe 1(një) kontratë është për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë si dhe të materialit drusor të vlerësuar në ngastrat pyjore të dëmtuara nga faktorët të ndryshëm natyrore, njerëzore dhe nga zjarret.

Janë dhe 2(dy) kontrata e ekzistuese konçesioni për shfrytëzimin e materialit drunor në këmbë në ngastrat e nëngastrat pyjore pa rrugë autopsyjore e vitit 2008 (kontrata nr.1, datë 02.10.2008) dhe e vitit 2011 (kontrata nr.1, datë 04.07.2011) të fituara me ankand dhe Bashkia Gramsh ka lidhur 14 (katërmbëdhjetë) aneks-kontrata.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të shfrytëzimit të pyjeve (ngastrave/nënngastrave e grupngastrave pyjore) nga institucionet ,banorët e zonave apo dhe nga firmat shfrytëzuese ku zhvillohet ky aktivitet nuk kemi patur ankesa.

Për çdo shkelje ligjore që është vërejtur gjatë zhvillimit të aktivitetit të shfrytëzimeve pyjeve nga ana e personelit pyjor është mbajtur qëndrim ligjor sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Aktiviteti i shfrytëzimit të pyjeve zhvillohet sipas studimeve duke zbatuar planet e mbarështimit të miratuara të ekonomive pyjore dhe miratohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mbi mundësinë vjetore të vjeljes së materialit drusor.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

KRYETARI

Klodian TAGE

